

VENDIM
Nr.395, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV ONUFRI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.014/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Onufri TV” sh.a. për televizionin “TV Onufri”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj